

BULETIN







Kontakte

Adresa: Lagja 14, Mbikalimi i Shkozetit Durrës - Shqipëri

Mobile: +355 69 74 99 292

Web: durrës.turgutozal.edu.al

E-mail: infodurres@turgutozal.edu.al

Facebook: [turgutozaldurresofficial](https://www.facebook.com/turgutozaldurresofficial)

Instagram: [turgutozal_collegedurres](https://www.instagram.com/turgutozal_collegedurres)

Dita e parë e kopshtit



Smart-Board

Ecuria e fëmijës ndikohet edhe nga kushtet mësimore që i ofrohen. Në klasat e parashkollorit fëmijet përdorin mjaft mirë tabletat smart-board. Teknologjia bashkëkohore që u ofrohet në ambientet tona e bën orën mësimore gjithmonë më praktike dhe interesante gjithashtu. Kështu ata janë gjithmonë në koherencë me risitë duke u dhënë mundësinë për të pasuruar informacionet dhe teknologjinë.



Oborri

Përveç argëtimit të ndryshme lojë në oborr është një aktivitet më shumë për të vegjëlit tanë. Zërat e tyre gazmorë i japin gjallëri ambientit duke bërë që ata të ndihen sa më komod gjatë orëve që kalojnë në kopshtin tonë. Këtu ne organizojmë lojëra të ndryshme ku fëmijet ndihen të lirshëm dhe shprehin dëshirën për të shijuar natyrën e bukur në oborrin e kopshtit.





Dhoma e gjumit

Rehatia e fëmijëve tuaj është prioriteti ynë! Gjumi ka një rol të rëndësishëm dhe thelbësor që një fëmijë të zhvillohet i shëndetshëm. Prandaj nuk kishte si të mungonte një ambient i përshtatshëm dhe i veçantë për gjumin e të vegjëlve tuaj. Infrastruktura e kolegjit tonë ofron mjedise të ngrohta në dimër dhe të freskëta në verë. Fëmijët rriten në një ambient të pastër me krevate të rehatshëm për një gjumë çlodhës e ripërtëritës energjie.



Ekskursione



Kërcimi

Ndër momentet e shumëpritura për fëmijët është aktiviteti i kërcimit. Ky aktivitet zhvillohet në sallë të madhe dhe të përshtatshme me mësuesen e kërcimit. Gjatë orëve të caktuara të këtij aktiviteti, fëmijët mësojnë lloje të ndryshme kërcimesh. Arti i kërcimit e bën fëmijën të futet më shumë në atmosferën e argëtimit dhe socializimit me njëri-tjetrin. Nuk janë të pakta aktivitetet festive të fëmijëve ku janë të spikatura talente të vegjël me lirshmëri, përshtatje e dashuri të veçantë për skenën.



Aktivite të ndryshme



Mensa

Ajo që është më e rëndësishme për rritjen dhe një shëndet më të mirë për fëmijët është mënyra e ushqyerjes. Në mensën e kopshtit tonë ofrohet ushqim i kontrolluar dhe i përshtatshëm sipas grup-moshave të ndryshme. Kujdesi ndaj ushqimit, higjenes dhe shërbimit nuk mungojnë asnjëherë. Kështu fëmijët tuaj janë të sigurt dhe të shëndetshëm.



Festa të ndryshme



Muzika

Të gjithë e dimë sa e rëndësishme është muzika, artet dhe kultura në jetën e njeriut, e veçanërisht te fëmijët. Kultura dhe arti janë thelbësore në edukimin dhe në mbështetjen që i japin zhvillimit thelbësor të fëmijëve. Përfitimet që vijnë nga edukimi artistik në mënyrë të veçantë për fëmijët është i jashtëzakonshëm, pasi ai luan një rol të rëndësishëm në kultivimin e shijeve artistike dhe i bën ata mendjehapur dhe kreativ.



Kinema



Ditëlindjet

Ditëlindja e fëmijës është festë që e gjallëron atmosferën në familje dhe shoqëri. Ajo sjell kënaqësi si për fëmijët, prindërit dhe shokët e kopshtit pasi fëmijët e ndjejnë gëzimin e kësaj dite me bashkëmoshatarët e tyre. Pra, festa e ditëlindjes së fëmijës jo vetëm që sjell gëzim, hare e kënaqësi të posaçme, por lë dhe mbresa të thella e të paharrueshme të fëmijët, mbasi ajo është festa e tyre të cilën e festojnë njëherë në vit.



Klasat tona



Këndi i lojrave

Loja është një ndër veprimtaritë e rëndësishme në jetën dhe zhvillimin e fëmijëve. Loja bën të mundur që fëmijët të rriten të shëndetshëm dhe i njeh me botën që i rrethon. Gjatë lojrave fëmijët krijojnë komunikim dhe bashkëveprojnë me moshatarët e tyre. Kjo gjë i bën ata të zhvillojnë aftësitë e tyre duke krijuar kështu vetëbesim në personalitetin e fëmijës.



Anglisht

Pjesë e procesit mësimor në kopshtin tonë është edhe gjuha e huaj. Aktivitetet kreative bëjnë të mundur që fëmijët tek ne të kenë avantazhin jo vetëm të luajnë e të rriten, por edhe të krijojnë një fjalor më të pasur në gjuhën angleze. Mësimdhënia i përket standarteve bashkëkohore e shoqëruar me paisjet më të mira teknologjike. Trajtimi i orës mësimore me mjete didaktike dhe zhvillimi i temave më anë të lojës, librave me figura, nxisin kreativitetin dhe rrjedhshmërinë në të folur.





Eja
Merr

Rit akohemi

EMR KANCELARI



Ju mirepresim
ne adresen
e mijera produkteve
qe mbajne
mbiemrin e cilesise
#1 ne treg.



ADRESA

CITYPARK SHOPPING MALL, kati 2

TIRANA RING CENTER, kati 3

email: emrkancelari@gmail.com



emr kancelari